



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “THOMA PAPAPANO” GJIROKASTËR

Nr. 215 Prot.

Gjirokastrë, më: 21/09 / 2023

Lënda : Njoftim për vend të lire:

Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funkcionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore , përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional “,

Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë ,ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin mësimdhënës me kohë të pjesëshme të “Teorisë Profesionale”:

Mësimdhënës i lëndës “Teori Profesionale ” në drejtimin mësimor “Teknologji Informatike dhe Komunikimi” Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

